



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 11. 07. 2019

VENDIM

Nr. 36, datë 11. 07. 2019

**PËR
SHQYRTIMIN E VENDIMEVE NR. 24, 25 DHE 27 DATË 01.07.2019 TË SENATIT
AKADEMIK, NË MBLEDHJEN MË TË PARË, PAS PLOTËSIMIT ME
RELACIONIN SHOQËRUES**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 59 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre", si dhe në Vendimet nr. 24, 25 dhe 27 datë 01.07.2019 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 11. 07. 2019,

VËREN SE:

Pranë sekretarisë së Bordit të Administrimit janë përcjellë vendimet nr. 24, 25 dhe 27 datë 01.07.2019 të Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Në vendimet në fjalë Senati Akademik ka miratuar hapjen e dy programeve të reja të studimit dy vjeçar dhe hapjen e një programi të ri Master Shkencor dhe i kërkohet Bordit të Administrimit, miratimi i mëtejshëm, sipas parashikimit të pikës 7, shkronja ë) e VKM-sw nr. 418, datë 10.05.2017. Bordi Administrimit sipas parashikimit të nenit 47 të LAL Nr. 80/2015, është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili ka për qëllim kryesor mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare dhe administrative të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Këto funksione BA i ushtron në bazë të kompetencave të njohura në nenin 49 të LAL, në funksion të Autonomisë financiare përcaktuar në nenin 3 të LAL. Ky i fundit parashikon se " *Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës...*

- për të përcaktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit (neni 3, pika 3 shkronja c);

- për të përcaktuar tarifën e studimit, në përputhje me këtë ligj (neni 3, pika 3 shkronja ç).

Në këtë kontekst, B.A në vendim marrjen e tij ka si qëllim kryesor garantimin e qëndrueshmërisë financiare të U.V, por dhe cilësinë në mësimdhënie në funksion të studentëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Bordi Administrimit vë re se vendimet në fjalë të Senatit Akademik, për të cilat kërkohet miratimi i BA-së, nuk shoqërohen me asnjë lloj relacioni shoqërues si p.sh. studimi i tregut dhe nevoja që ka çuar në vendimarrje për hapjen e këtyre programeve, analizë kosto studenti sipas programit të studimit, efektet financiare që duhet të përballohen për hapjen e këtyre programeve etj. Bordi vë re se mungon gjithashtu plani-biznesit dhe përlllogaritja e mbulimit të shpenzimeve për zhvillimin e veprimtarisë akademike, për një periudhë 3 vjeçare, kriteret këto të përcaktuara në pikat iii) dhe iv) shkronja ç) pika 7 e VKM-së nr.418, datë 10.05.2017. Mbi të gjitha, nuk ka një propozim mbi tarifën për këto programe studimi që kërkohen të hapen, propozim i cili duhet të bazohet mbi bazën e analizës së koston, siç është parashikuar dhe në Rekomandimin nr. 8 të Kontrollit të Lartë të Shtetit në auditimin me temë "Cilësia dhe tarifimi i shërbimeve studentore pranë IAL-ve publike", miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 229, datë 20.12.2018.

Nga sa u parashtrua mësipër, në përfundim BA në mbledhjen e datës 11.07.2019,

VENDOSI:

1. Të shqyrtojë Vendimet e Senatit Akademik nr. 24, 25 dhe 27 datë 11.07.2019 në mbledhjen e parë sa më të afërt, vetëm pasi të jenë plotësuar me relacionet financiare dhe materialin shoqërues-justifikues nga drejtoritë përkatëse, apo organet dhe autoritetet që kanë propozuar vendimarrjen.
2. Kopje e këtij Vendimi i përcillet për dijeni Senatit akademik dhe Rektoratit.

Anjeza Shiko – Anëtar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Enrik Mehmeti – Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar

Dr. Marinela Muço – Anëtar

Dr. Ervis Moçka – Kryetar

